

# Newspaper

## TO THE RIGHTS OF PERSONS

## WITH DISABILITIES OF KOSOVA

Revista e cila merret me të drejtat e personave me aftësi të kufizuara

Mirë se erdhët në botën tonë

Kjo gazetë joprofitabile botohet në 6 gjuhë: si shtojcë në gjuhën shqipe distribuohet përmes të përditshmes (Koha Ditore), në gjuhën boshnjake përmes (Alem), në gjuhën rome ( Yehkipe) dhe gjuhën turke (Jeni Donem). Në këto gjuhë dhe versionin anglisht e sërbiisht mund ta lexoni edhe përmes website [www.lpkosova.com](http://www.lpkosova.com) Bashkpunëtore vullnetare e redaksisë Diana Toska.

Donatori:



Schweizerische Eidgenossenschaft  
Confédération suisse  
Confederazione Svizzera  
Confederaziun svizra

Swiss Cooperation Office Kosovo

"Ky projekt u financua përmes grantit të zyrës së SHBA-ve në Prishtinë. Mendimet, përfundimet dhe konkludimet apo rekomandimet e shprehura këtu janë të Autorit(ëve) dhe jo mendoemos pasqyrojnë qëndrimet e Departamentit të Shtetit."



TETORI - MUAJI I MUNDESIVE PROFESIONALE

Page 6

## KULTURA E TË DREJTAVE TË NJERIUT

Kosovë, 10. dhjetor 2007

Dita ndërkombtare e të drejtave të njeriut, 10.dhjetori ishte një rast i mirë për tërheqjen e vëmendjes së opinionit kosovar e sidomos pushtetarëve mbi kulturën e të drejtave të njeriut dhe respektimin e dinjitetit njerëzor me theks të veçantë në personat me aftësi të kufizuara, OJQ-të e mbledhura rreth Programit DMD Disability Mentoring Days, dërguan porosi "Të drejtat e njeriut janë tuajat" dhe e njejtja është publikuar në të gjitha mediumet në Kosovë.

Donatorë, ishin Zyra Amerikane dhe OSBE-ja me përkrahje nga Këshilli i Europës, Ministris së Shëndetësis, Zyrës për qeverisje të mirë.

Të përkujtojmë, "Të gjithë janë të lindur të lirë me dinjitet të barabartë" thotë neni 1 i konventës mbi të drejtat e njeriut. Me të lindur dhe që në çastet e para të jetës njeriu gëzon të drejta. Ato janë të garantuara, të patjetërsueshme dhe të rregulluara me një sërë dokumentesh ndërkombtare.

Dita Ndërkombëtare e të Drejtave të Njeriut  
Dhjetor 2007

## TË DREJTAT E NJERIUT JANË TUAJAT

Të lirë & Të barabartë

Liri e të shprehurit

Edukimi

Integriteti

Pa diskriminim

Qasje

Dinjiteti

Dallimet

NGJARJET QË SHËNUAN VITIN 2007

BONTONI I DINJITETIT

" DIZAJN UNIVERZAL "

RESPEKT PËR TË GJITHA GRATË E BOTËS

January /  
Janar 2008

014

Viti V - Mujore - www.lpkosova.com - tel: 028/ 533 996; 044 / 293-518, 063 - 853 88 24

# APEL - Ndhimë për të ndihmuar

Ferizaj, janar 2008.

Në kuadër të OJQ Hendifer u themelua "Ortopedia" puntoria për prodhimin dhe ndreçjen e mjeteve ndihmëse ortopedike. Kjo punëtori kërkon ndihmë urgjente nga Institucionet që të mund ta vazhdoj punën. Vazhdimi i punës së kësaj puntorie është e një rëndësie të veçantë, pasi që do të kursente buxhetin e Kosovës, nga blerja e këtyre mjeteve ortopedike nga jashtë e të cilat janë tejet të shtrejtja. Puntoria në krizë është prodhuesi i vetëm dhe eksportuesi i vetëm në rajon.

Kjo punëtori ofron program të pasur prodhues me mbi, 200 lloj mjete ortopedike : kujza, të gjitha llojet e karrocave për fëmijë e të rritur, karroca higjienike, mjete ndihmëse për banjo, mbështetëse për shkallë, e shumë gjësende të vogla të nevojshme për njerëzit me aftësi të kufizuara.

Me donacion nga World Bank dhe World Vision gjatë 2006 u themelua kjo punëtori.



## PARAOLIMPIJADA ! Spektakl Planetar sportiv

Peking ( Kinë), 06 17shtator 2008



Olimpiada dhe Paraolimpiada *do të jenë të* organizuara në nivelin më të lartë, ndërsa hapja e spektaklit planetar sportiv për personat me aftësi të kufizuara është caktuar për 06 shtator 2008.

Përgaditjet në Kinë për lojrat Olimpikë dhe Paraolimpikë po bëhen që 6 vite. Tani më kinezët kanë filluar t'i bëjnë edhe provat e para të hapjes solemne.

Janë në përfundim e sipër punimet për Paraolimpiadë. Ceremonia e hapjes dhe mbylljes do të theksoj vlerat e jetës nën moton " Qielli, Toka dhe Qenjet Njerëzore"

Anë e mbanë planetit tonë po trajnohen sportistët me aftësi të kufizuara për t'i thyer rekordet botërore dhe për të fituar sa më shumë medalje të arta në Paraolimpiadë.

## EKSPOZITA E FËMIJËVE

Pristinë 10. dhjetor 2007:

-Me rastin e ditës ndërkombtare të të drejtave të njeriut u mbajt ekspozita njëditore e punimeve të nxënësve e punimeve të nxënësve nga shkolla speciale. Ekspozitën e shpalli të hapur, ushtruesi i detyrës së Ombudsmanit, z.Hilmi Jashari, i cili theksoi rëndësin e mbrojtjes së të drejtave të fëmijëve.



## Mirënjohje për Bytyqin

Pristinë 25.dhjetor 2007: - Në organizim të Koha Grup u mbajt ceremonia tradicionale e promovimit të sportistëve më të suksesshëm të vitit 2007.

Në mesin e tyre një mirnjohje fitoi edhe sportisti , Daut Bytyqi, i cili vendosi rekord të ri botëror në gjuejtjen me shtizë në kampionatin e IV botëror për persona me aftësi të kufizuara të mbajtur në Rambuje më 2005, me çrast, Kosova fitoi kushtin për pjesmarje në Paraolimpiadën që do të mbahet në Kinë më 2008.



**Daut Bytyqi , shampion i Rambujes**

## PTK NDIHMON TË VERBËRIT

Pristinë, 16 nëntor2007

Posta dhe Telekomunikacioni i Kosovës së bashku me shoqatën e të verbërve të Kosovës nënshkruan një memorandum mirëkuptimi, me të cilin PTK obligohet që të trajnoj fillimisht e më pastaj t'i punsoj disa persona të verbër. Këtë nismë e ndërmori, Drejtori gjeneral, dr. Etrur Rustemaj, me një arsye të vetme, kyçjen e kësaj kategorie qytetarësh në shoqërin kosovare.

"PTK-a, mes projekteve të ndryshme do të vazhdoj t'i ndihmoj personat me aftësi të kufizuara. Prandaj apeloj tek kompanitë tjera, që ta ndjekin rrugën e tyre, - theksoi Rustemaj, në fund të këtij takimi shpresdhënës.

Ndërsa, kryetari i Shoqatës së të verbërve të Kosovës Bujar Kadriu tha se nënshkrimi i këtij memorandum do të hap rrugë për punësimin e më së paku 10 personave të verbër në PTK.

"Fillimisht 10 persona të verbër do të vijnë nën kurset në qendrën trajnuese në kuadër të PTK-së, dhe më pas të njejtit do të punësohen në Call Qendrën. Këto familje tash më do ta zbusin gjendjen e rëndë sociale që kanë, - nënvizoi Bujar Kadriu.

( marrë nga Magazina e PTK)



**z. Bujar Kadriu (majtas)dhe z., Etrur Rustemaj**

# KUNDËR DISKRIMINIMIT



Falenderojmë donatorët për mundësin që na e dhanë që sërish të takohemi me lexuesin në këtë fillim viti të ri, duke u botuar në gjashtë gjuhë dhe duke qenë afër jush edhe mes adresës website: [www.lpkosova.com](http://www.lpkosova.com)

Shfrytëzoj nga rasti t'u përkujtoj lidhur me ligjin, kundër diskriminimit i cili është ligj i parë mbi të drejtat e njeriut e i cili duhet implementuar edhe në Kosovë. Ky ligj është tejet i rëndësishëm për ne sepse drejtpërdrejt mbron intereset e personave me aftësi të kufizuara.

Prandaj të gjithë së bashku në shtetin që po presim ta shpallim të pavarur, të përpiqemi t'i ndërtojmë dhe realizojmë parimet e " Dizajnit Univerzal".

Të bashkpunojmë me Institucionet e reja të dala nga vota e popullit, të gjejmë rrugët më të lehta për kapërcimin e barrierave dhe ndërtimin e mundësive të barabarta për të gjithë qytetarët e Kosovës e veçanarisht ata me aftësi të kufizuara.

Me respect e juaja,

Hilmnijeta Apuk,

## KESHILLI NACIONAL

Pritet përkrahje nga Qeveria dhe Kryeministri i ri i Kosovës për Këshillin Nacional të personave me aftësi të kufizuara që vepron në kuadër të Zyrës së Kryeministrit.

Punën e mëtejme të këtij Këshilli duhet orientuar kah parimet e reja të Konventës mbi të drejtat e personave me aftësi të kufizuara për t'i dhënë dimenzionin real për përgaditjen e kushteve për implementimin e saj në Kosovë.



Detaj nga mbledhja

Këtë numër mund ta lexoni në internet në gjashtë gjuhë: Anglisht, Shqip, Sërbisht, Boshnjake, në gjuhën rome dhe turke si dhe në websit adresën: [www.lpkosova.com](http://www.lpkosova.com)

## PER TE DREJTA UNIVERSALE

Zyra për Qeverisje të Mirë e Kryeministrit përmes rolit të saj monitorues dhe koordinues me Ministrinë e Qeverisë së Kosovës dhe në veçanti përmes aktiviteteve të zbatuara në bashkëpunim të ngushtë me Njësitë për të Drejtat e Njeriut të krijuara në secilën Ministri të Qeverisë së Kosovës, po bën përpjekje që të sigurojë që shërbimet e ofruara dhe kualiteti i qeverisjes të ndikojë në mbrojtjen dhe realizimin e të drejtave të njeriut për të gjithë qytetarët e Kosovës.

Vëmendje e veçantë është duke ju kushtuar grupeve që janë në pozitë më të pafavorshme duke përfshirë personat me aftësi të kufizuara dhe gratë. Këto grupe dhe grupe të tjera që kanë nevoja akute kanë qenë dhe do të mbeten prioritete në politikën e planifikimit strategjik të Qeverisë së Kosovës, dhe në këtë kuadër Zyra për Qeverisje të Mirë e Kryeministrit ka filluar hartimin e disa dokumenteve të rëndësishme në mënyrë që të mund të adresohen në mënyrë adekuate këto nevoja.

Ne jemi të vetdijshëm që të drejtat e njeriut kanë ndikim në tërë shoqërinë e Kosovës, dhe në këtë mënyrë, zbatimi i tyre në praktikë është përgjegjësi e të gjithëve në Kosove, përfshirë sektorin joqeveritar.

Si institucione të qeverisë në do të jemi të angazhuar dhe kemi detyrë që të punojmë dhe të sigurojmë një të ardhme më të mirë për të gjithë njerëzit që jetojnë në Kosovë, prandaj edhe ato projekte që do të realizohen në fushën e të drejtave të personave me aftësi të kufizuara do të mundësojnë që të drejtat e njeriut në Kosovë të praktikohen me respekt për barazinë universale, për lirinë dhe dinjitetin e secilit qytetar të Kosovës.

z, Habit Hajredini, Drejtor i Zyrës për qeverisje të mirë

## Ndëroi jetë XHEVAT ISLAMI

(28.03.49 - 23.08.2007)

### Luftëtari i palodhur për të drejtat e njeriut

Më 23 shtator 2007 pushoi së rrahuri zemra e luftëtarit të madh për të drejtat dhe lirit e njeriut, për barazi dhe tolerancë multietnike. Nuk kurseu mund edhe përkundër vështërsive objektive dhe shëndetit të lig që kishte që deri në fund të jetë së tij të mbetet aktiv në realizimin e idealit të tij, mbrojtjen e të drejtave dhe lirive të njeriut e posaqërisht të atyre me aftësi të kufizuara.

Xhevat Islami ishte personalitet i veçantë: humanist dhe luftëtar, inovator i mjeteve ortopedike, themelues i OJQ Hendifer në Ferizaj, dhe i Programit multietnik DMD në Kosovë, bashkëpunor i ekipit të Shoqatës Amerikane për personat me aftësi të kufizuara AAPD, punoi në implementimin e

Programit DMD, bashkëpunoi me OJQ Hendikos- ishte sportist, lider i dashur, zhvilloi sistemin e shërbimeve të servisit për nevojtarët, ishte autor i bibliotekës mobile, ishte i dashur për të gjithë. Ishte njeri që gjente zgjidhje dhe kërkonte përgjigje, pas tij mbetën rezultatet, ndërsa kohës që e jetoi i dha vullën njerzore.

Xhevat Islami ka mundur edhe shumë kohë të koontribuoj në përmisimin e statusit të personave me aftësi të kufizuara. Me vdekjen e tij ne humbëm luftëtarin më aktiv të të drejtave të njeriut.

Për bashkëpunimin dhe shoqërin e sinqertë që patëm i falenderohemi përzemërsisht.

## IM MEMORIAM



# " DIZAJN UNIVERZAL " - TË NDERTOJME MUNDËSI TË BARABARTA

Prishtinë, 14 shkurt 2007

Tre vite me rradhë, në ditën e Shën. Valentinit, e njohur edhe si dita e të dashuruarve, po organizohen manifestime të respektimit të dinjitetit për personat me aftësi të kufizuara. Por, e veçanta e organizimit të kësaj të fundit ishte se tematika ishte plot domethënje, "Dizajni Univerzal".

## Çështë » Dizajni Univerzal« ?

Viteve të 70-ta në SHBA kishin filluar të realizohen parimet e " Dizajnit Univerzal " ose "Dizajn për të gjithë" , i cili tani aplikohet në të gjitha vendet me standarde të përcaktuara dhe çasje të barabartë për të gjithë njerëzit duke përfshirë edhe ata me çfarëdo aftësi të kufizuara që kanë.

## Rrjedha e manifestimit

Mediumet në përgjithsi kanë shfaqur posterin me porosi, ndërkohë që debati është zhvilluar në temën multidisiplinare " Dizajni Univerzal". Në debat morrën pjesë, përfaqësues nga Qeveria, nga Ministria e ambientit, Ministria për punë, Zyra për qeverisje të mirë, Zyra Amerikane, OSBE-



14.shurt, 2007

# Qasje për të gjithë





[www.lpkosova.com](http://www.lpkosova.com)

ja,etj. Konstatim i përbashkët ishte se barrierat e ndryshme arkitektonike, sot në Kosovë janë realitet, ndërsa ndërtimi dhe renovimi i objekteve publike në pronësi si shoqërore ashtu edhe private duhet të ofrojnë mundësi të barabarta për çasje sipas nevojave të shfrytëzuesve. Në të kundërtën do të vazhdohet me diskriminim ndaj personave me aftësi të kufizuara.

Përmes ngritjes së vetëdijes si dhe me anë të ligjit dhe masave të tjera administrative duhet zhvilluar dhe inicuar, " dizajnin univerzal" i cili është koncept i realizueshëm për zhvillimin e mundësive të barabarta për çasje në Kosovë.

Ky manifestim është pjesë e pakos programore për promovimin e të drejtave të njeriut me titull - Programi vullnetar i DMD. Donator ishte OSBE-ja, ndërsa organizator , OJQ Little People of Kosovo dhe OJQ Hendifer Ferizaj.

# RESPEKT PËR TË GJITHA GRATË E BOTËS

Prishtinë 8 mars 2007

Dita ndërkombëtare e gruas tradicionalisht u shënua me një shfaqje teatrale dhe debat të hapur në Teatrin Kombëtar në Prishtinë, me çrast u hap çështja e barazisë gjinore dhe të drejtat e gruas me dhe pa aftësi të kufizuara.

Në diskutim morri pjesë edhe z. Per Oeyvind Semb nga OSBE-ja, i cili theksoi se është e domosdoshme dhe tejet e rëndësishme të respektohet barazia gjinore në jetën si private ashtu edhe publike.

"Duke pranuar se jeta e gruas pa dhe me aftësi të kufizuara në mbarë botën nuk është aspak e lehtë, shpeshherë e përcjellur me dhunë, e eksploatuar e lënë në mëshirën e shoqëris, rob i trafikimit me qenje njerëzore, jo rrallë herë lëvizjet i janë të kufizuara për shkak të paragjytimeve patrijarkale, mortaliteti në mesin tonë është mjaft i lartë, varfëria dhe analfabetizmi janë pjesë e përditshmëris sonë, ndërkohë që përqindja e jonë në biznes është tejet e ulët, në arsimimin e lartë, e për pushtet të mos flasim.

Në bashkëpunim me mashkullin mund t'i arimë qëllimet e shekullit



21, në të cilin gruaja me ose pa kufizime mund të punësohet, të bëhet e suksesshme, e pavarur, e informuar dhe e lumtur në familje e shoqëri.

Të bëhemi një familje e lumtur dhe të realizojmë qenjen tonë njerëzore në bazë të barazisë dhe jodiskriminimit gjatë të

gjitha 366 diëve sa i ka viti! "- theksoi Hiljmnijeta Apuk.

Edhe z. Habit Hajredini, Drejtor i Zyrës për qeverisje të mirë tha se Qeveria po bënë përpjekje për avansimin e pozitës së gruas dhe zhvillimin e barazisë gjinore në shoqërin kosovare.

Porosin e fushatës, TË DREJTAT TUAJA = TË DREJTAT E MIA, keni mund ta shihni në të gjitha TV kanalet ( RTK, TV 21 dhe TV Most), në gazetatat ditore, në bilborda, pamflete dhe në maicat që janë shpërndarë gjatë fushatës. Donator dhe organizatori kryesor i fushatës ishin OSBE, UNKT Kosovo Team, UN Volunteers, OHIR, Zyra Amerikane, Zyra për qeverisje të mirë dhe partnerët OJQ-të në programin multietnik DMD, singertë të Ministrisë së Shëndetësis, OJQ Little People of Kosovo dhe OJQ Hendifer Ferizaj.



# JAVA E TË DREJTAVE TË NJERIUT ME AFTËSI TË KUFIZUARA PËR SOT DHE TË ARDHMËN - TË DREJTAT TONA

Prishtinë, 23 30 prill 2007

Në përputhshmëri me nevojat dhe gjendjen e 10% të popullsisë ose 250.000 qytetarëve me aftësi të kufizuara në Kosovë e të cilët kanë ambicje për t'u bërë të barabartë me të tjerët u organizua fushata, »Java e të drejtave të njeriut me aftësi të kufizuara» me qëllim të promovimit të Konventës së re mbi të drejtat e njeriut. Donator të kësaj fushate ishin, Zyra Amerikane, ndërsa organizatore ishte partnerët OJQ-të në programin multietnik DMD dhe përkrahjen e singertë të Ministrisë së Shëndetësisë, Zyrës për qeverisje të mirë dhe PTK.

## Filatelia në afirmimin e Konventës së re

Me Promovimin e seris së XXII të pullave postale e cila është e vetme dhe e para e këtij lloji në botë e dedikuar Konventës për të drejtat e personave me aftësi të kufizuara u hap fushata "Java e të drejtave të

personave me aftësi të kufizuara në Kosovë". Seria përbëhet nga 4 pulla postale dhe Kovertë dhe tanimë po jep kontribut të veçantë filatellis botërore dhe agjendës së të drejtave të njeriut. Autorë të dizajnit janë personat me aftësi të kufizuara.

Promovimin e këtyre pullave postale e kanë përkrahur, z.Joakim Ruker (Joachim Rucker), z.Lawrence Corwin ; z.Blerim Baruti, Hilmnijeta Apuk.

Iniciator të kësaj serie të vetme të pullave postale është OJQ Little People of Kosova.

## BONTONI I DINJITETIT

Gjatë fushatës është publikuar broshura në tri gjuhë me moton " Bontoni gjatë komunikimit me personat me aftësi të kufizuara: Dinjiteti ynë = Dinjiteti juaj« dhe përshkrimi i shkurtër i Konventës mbi të drejtat e personave me aftësi të kufizuara, autorë të së cilës janë, Hilmnijeta Apuk dhe Fazile Bungu.

Fushata ka përfunduar me një konferencë për shtyp në të cilën janë lexuar rekomandimet e marra gjatë aktivitetëve që janë zhvilluar në Prishtinë, Ferizaj, Shtërpçë, Elez Han, Mitrovicë dhe Pejë, e në të cilat kërkohet nga Qeveria miratimi i ligjeve adekuate.



z.Lawrence Corwin zëdhënës i Zyrës Amerikane në Prishtinë



# PRESIDENTI PRET AMBASADORËT

Prishtinë 01.qershor 2007

Presidenti i Kosovës, Fatmir Sejdiu priti fëmijët Ambasadorë me rastin e ditës ndërkombëtare të fëmijëve. Ky grup multietnik i dorëzoi letrat kredenciale presidentit me porosi mbi të drejtat e tyre.

## Promovohen të drejtat e fëmijëve

Në Prishtinë, fëmijët Ambasadorë me ftesë të PTK-së morrën pjesë në promovimin e serisë së XXIV të pullave postale të quajtur "fëmijët e qeshur" që i është kushtuar, "1 qershorit ditës ndërkombëtare të fëmijëve".

Në Mitrovicë, Pejë, Ferizaj, fëmijët ambasadorë, nga mjediset e tyre kanë vizituar kryetarët e komunave të tyre dhe duke mbajtur nga një kuvend të fëmijëve kanë përcjell mesazhet që i kanë dërguar, presidentit të Kosovës. Ky ishte edhe një rastë i mirë që edhe në këtë mënyrë

fëmijët të njoftohen pak më shumë mbi të drejtat e tyre.

Kjo ditë u shënua nga të gjitha televizionet, shtypi ditor në të gjitha gjuhët, dhe u vendosën pllakate e billborde në mbarrë Kosovën.

Donatorë të këtij manifestimi tradicional ishin Zyra Amerikane, OSBE-ja, ndërsa organizator, partnerët e OJQ-ve që mbështesin Programin DMD me përkrahje të Ministrisë së Shëndetësisë, OJQ Little People of Kosovo dhe OJQ Hendifer Ferizaj.



Kuvendi i fëmijëve në Mitrovicë



Presidenti Fatmir Sejdiu në takim me Ambasadorët e vegjël

# TETORI - MUAJI I MUNDËSIVE PROFESIONALE

**Personat me aftësi të kufizuara mund të japin kontributin e tyre në sfera të ndryshme profesionale**

Prishtinë, 05 tetor 2007



Ceremonia e hapjes së fushatës njëmuajore, "TETORI muaji i mundësive profesionale" u mbajt në Prishtinë dhe tuboi përfaqësues të institucioneve lokale e ndërkombtare, të sektorit privat dhe persona me aftësi të kufizuara, të cilët bashkërisht përkrahën promovimin e mundësive profesionale për personat me aftësi të kufizuara dhe mundësin e punësimit pa diskriminim.

Tubimin e hapi z. Habit Hajredini, Drejtor i Zyrës për qeverisje të mirë, ndërsa fjalë përshëndetëse patën edhe z. Laura Hoxha nga Zyra Amerikane, z. Markku Laamanen, Zëvendës shef i misionit të OSBE-së, Ministri i Shëndetësisë, prof. Sadik Idrizi, Përfaqësuesja e Ministrisë për punë, z. Gjylinaze Novobrdaliju Golja, Kryetari i keshillit kombëtar, Dr. Fadil Kryeziu, Violeta Krasniqi nga Ombudspersoni i Kosovës, Hiljmnijeta Apuk nga OJQ Little People of Kosova, Fazile Bungu nga OJQ Hendifer dhe shumë diskutant tjerë.



punuar në harmoni me potencialin e tyre, në fakt, paraqet pjesë të ekonomisë së shëndoshë.

Personat me aftësi të kufizuara ballafaqohen me një shkallë më të lartë të papunësisë dhe diskriminimit në krahasim me popullatën, gadi në çdo shtet të botës. Hulumtimet kanë treguar se efektet në punë të këtyre personave janë po aq të mira, ndonjëher edhe më të mira, se sa te popullata tjetër. Një anketë e bërë më 2003, në SHBA ka dëshmuar se afro 80% e punëdhënësve kanë njoftuar se për të punuarit me aftësi të kufizuara, nuk është dashur asnjë plotësim shtesë të bëhet në vendet e tyre të punës, se kanë dhënë rezultate të lakmueshme në punë dhe se

kanë munguar më pak në punë se popullata tjetër.

## Aktivitetet gjatë fushatës

Në të gjitha mjediset e Kosovës gjatë këtij muaji u punuan gjithsej, 950 ditë pune nga personat me aftësi të kufizuara. Ishin të kyçur rreth 900 vullnetar në rolin e mentorit dhe shpjegimin e punëve të ndryshme. Numër më të madh të ditëve të punës gjatë fushatës kanë organizuar, OJQ Hendifer nga Ferizaji, Shtërca dhe Elez Hani.

Kompani të shumta, punëdhënës privat, institucionet publike gjatë një dite të vetme kanë punësuar me pagë personat me aftësi të kufizuara dhe kanë pasë mundësi të shohin aftësitë e tyre profesionale.

Duhet theksuar se që tre vite me rradhë Dogana e Kosovës, ka punësuar personat me aftësi të kufizuara nëpër zyrat e saja në mbarë Kosovën.



Fushata tradicionale njëmuajore "Tetori muaji i mundësive profesionale për personat me aftësi të kufizuara" ka për qëllim luftën kundër varfërisë, zbutjen e papunësisë, eliminimin e barrierave dhe luftën kundër diskriminimit me të cilën njerëzit me aftësi të kufizuara ballafaqohen për çdo ditë. Gjatë fushatës u promovuan edhe qëllimet e reja të Konventës mbi të drejtat e personave me aftësi të kufizuara dhe implementimin e saj në të ardhmen në Kosovë.

## FUSHATA NDERKOMBTARE

Fushata "TETORI Muaji i mundësive profesionale për personat me aftësi të kufizuara" është një iniciativë re e lirë që u ngrit në Amerikë dhe e cila ka për qëllim, eliminimin e barrierave dhe ngritjen e mundësive, apo kushteve të barabarta për personat me aftësi të kufizuara për kyqje në vende të reja të punës në mjediset ku jetojnë.

Edhe pse është e pamundur që të përcaktohet çmimi i të drejtave elementare të njeriut, është dëshmuar se sigurimi i kushteve për personat me aftësi të kufizuara për të jetuar dhe

Gjatë Tetorit opinioni publik kosovar pati rastin t'i shohë posterat nëpër medime, me moton "Pa DISKRIMINIM".

Zyra për qeverisje të mirë dhe këshilli nacional pranë Zyrës së Kryeministrit organizuan një konferencë me gazetarë me rastin e punësimit njëditor të 30 personave me aftësi të kufizuara.

Fushata njëmuajore "Tetori muaji i mundësive profesionale" është pjesë e pakos së programit njëvjeçar për promovimin e të drejtave të njeriut nën moton- Programi vullnetar promovues i DMD (Disability Mentoring Days).

Donator ish-in Zyra Amerikane, OSBE-ja, ndërsa organizator, partnerët e OJQ-ve që mbështesin Programin DMD me përkrahje të Ministrisë së Shëndetësisë dhe Zyrës për qeverisje të mirë.



Znj. Melissa Stone nga OSBE dhe z. Habit Hajredini, Drejtor i Zyrës për qeverisje të mirë gjatë paraqitjes në Konferencë për shtyp.



Misioni i OSBE-së në Kosovë ka donuar kurse profesionale për personat me aftësi të kufizuara me iniciativë të organizatës, Handicapped and Disabled People of Kosova.

Qëllimi i këtyre kurseve ishte çasja e barabartë në punësim dhe integrimi i plotë i tyre në shoqëri.

Ceremonia e ndarjes së diplomave u zhvillua më 15. qershor 2007 në lokalet e OSBE-së në Prishtinë. Ambasadori Werner Wnendt në fjalën e rastit i kushtoi rëndësi të posaçme zhvillimit inkluziv të shoqëris, për këtë kategori qytetarësh.



*Valbona Sahiti( djathtas )dhe Mehmet Kastrati,janë punësuar në Bankën Ekonomike në Prishtinë,pas mbarimit të kurseve.*

*Kosovë, gusht 2007*

KFOR-i Danez shpërndau një kontigjent të madh ndihmash, të mbledhura nga populli danez, e që përmbante, karroca dhe mjete të ndryshme ndihmëse ortopedike dedikuar për personat me aftësi të kufizuara në Kosovë.



## EKSPOZITA KOSOVARE EDHE NË AMERIKË

Me rastin e krenimit të 50 vjetorit të themelimit të Little People of America u organizua një ekspozitë ndërkombtare me punime nga personat me aftësi të kufizuara që u mbajt në Seattle USA nga 01 6 korrik 2007. Kosova në këtë manifestim u prezentua me moton » Iniciativa e re e Kosovës në Programin e DMD« me autore z. Hiljmnijeta Apuk.

Ekspozita nga Kosova u mirëprit nga publiku Amerikan dhe vendet e tjera .U tha se ajo promovoi të gjitha të drejtat e grave me aftësi të kufizuara dhe ariti të sensibilizoj opinionin me faktet e paraqitura.

Profesori nga Univerziteti Washington në Seattle, Dr. Prof. Paul Stiven Miller dhe Drejtor i Programit DMD në Amerikë ( Disability Mentoring Day) nga Washingtoni D.C. Mr. Andrew J. Imaprato e vlerësuan lartë ekspozitën nga Kosova për të theksuar se ajo njëherit është mënyrë e mirë për t'i promovuar të drejtat e njeriut në planin global.

Donator për pjesmarje të Kosovës në këtë ekspozitë në Amerikë ishin : Ministria e sportit, kulturës dhe rinisë, PTK dhe Mama Cash.



## BIBLIOTEKA MOBILE



Në bashkëpunim të OJQ Hendifer dhe bibliotekës së qytetit " Anton Qeta" në Ferizaj, u themelua biblioteka mobile me 560 libra. Qytetarët kanë mundësin të këmbejnë libra në adresat e personave me aftësi të kufizuara të cilët nuk kanë mundësi të shkojnë deri te biblioteka e qytetit. Lexuesit e interesuar që kanë nevojë për këtë lloj shërbimi mund ta kontaktojnë, Hendiferin në Ferizaj.

## EKSPOZITË PËR TË VERBËRIT

Ekspozita artistike e skulpturës nga muzeu i Luvrit ishte vendosur në Muzeun Kombëtar të Kosovës në Prishtinë nga 08. marsi deri nga mesi i prillit të 2007. Kjo ekspozitë ishte përshtatur për vizitorë të verbër, nga që përshkrimi i veprave ishte bërë me shkrimin e Brajtit. Donator ishin Zyra e Kryeministrit, Zyra Franceze dhe Shkolla për të verbër në Pejë.



## HUMANITETI NË VEPËR



Në fund të vitit të kaluar në lokalet e PTK-së u hap një ekspozitë e cila u vlerësua e karakterit human , meqë mjetet e tubuara nga shitja e pikturave i u dedikuan për shërim, autores Bahrije Sahitit.

# KONVENTA mbi të DREJTAT e PERSONAVE me AFTËSI të KUFIZUARA

# PO!



- \* të lirë & të barabartë
- \* pa diskriminim
- \* integriteti
- \* qasje
- \* dinjiteti
- \* dallimet



# 2008

**JANUARY**

SU	MO	TU	WE	TH	FR	SA
		1	2	3	4	5
6	7	8	9	10	11	12
13	14	15	16	17	18	19
20	21	22	23	24	25	26
27	28	29	30	31		

**FEBRUARY**

SU	MO	TU	WE	TH	FR	SA
					1	2
3	4	5	6	7	8	9
10	11	12	13	14	15	16
17	18	19	20	21	22	23
24	25	26	27	28	29	

**MARCH**

SU	MO	TU	WE	TH	FR	SA
						1
2	3	4	5	6	7	8
9	10	11	12	13	14	15
16	17	18	19	20	21	22
23	24	25	26	27	28	29
30	31					

**APRIL**

SU	MO	TU	WE	TH	FR	SA
		1	2	3	4	5
6	7	8	9	10	11	12
13	14	15	16	17	18	19
20	21	22	23	24	25	26
27	28	29	30			

**MAY**

SU	MO	TU	WE	TH	FR	SA
				1	2	3
4	5	6	7	8	9	10
11	12	13	14	15	16	17
18	19	20	21	22	23	24
25	26	27	28	29	30	31

**JUNE**

SU	MO	TU	WE	TH	FR	SA
1	2	3	4	5	6	7
8	9	10	11	12	13	14
15	16	17	18	19	20	21
22	23	24	25	26	27	28
29	30					

**JULY**

SU	MO	TU	WE	TH	FR	SA
		1	2	3	4	5
6	7	8	9	10	11	12
13	14	15	16	17	18	19
20	21	22	23	24	25	26
27	28	29	30	31		

**AUGUST**

SU	MO	TU	WE	TH	FR	SA
					1	2
3	4	5	6	7	8	9
10	11	12	13	14	15	16
17	18	19	20	21	22	23
24	25	26	27	28	29	30
31						

**SEPTEMBER**

SU	MO	TU	WE	TH	FR	SA
	1	2	3	4	5	6
7	8	9	10	11	12	13
14	15	16	17	18	19	20
21	22	23	24	25	26	27
28	29	30				

**OCTOBER**

SU	MO	TU	WE	TH	FR	SA
			1	2	3	4
5	6	7	8	9	10	11
12	13	14	15	16	17	18
19	20	21	22	23	24	25
26	27	28	29	30	31	

**NOVEMBER**


SU	MO	TU	WE	TH	FR	SA
						1
2	3	4	5	6	7	8
9	10	11	12	13	14	15
16	17	18	19	20	21	22
23	24	25	26	27	28	29
30						

**DECEMBER**

SU	MO	TU	WE	TH	FR	SA
	1	2	3	4	5	6
7	8	9	10	11	12	13
14	15	16	17	18	19	20
21	22	23	24	25	26	27
28	29	30	31			

Donatori:



 Schweizerische Eidgenossenschaft  
Confédération suisse  
Confederazione Svizzera  
Confederaziun svizra  
Swiss Cooperation Office Kosovo

